



ANEKS 7. Roli i Institucioneve Shqiptare në Planin Kombëtar të Integritit Evropian

Kuvendi i Shqipërisë¹ - Përgjegjësinë kryesore për planifikimin dhe propozimin e nismave ligjore e ka qeveria, por Kuvendi luan një rol shumë të rëndësishëm në procesin e përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë të BE-së, duke ushtruar kontrollin ligjor dhe politik të këtij procesi.

Këshilli Kombëtar i Integritit Evropian (KKIE)² - është struktura më e lartë këshillimore kombëtare për Integritin Evropian, i cili synon të nxisë dhe të garantojë bashkëpunimin ndërmjet forcave politike, institucioneve publike dhe shoqërisë civile, si dhe siguron rritjen e transparencës në vendimmarrjen për çështjet e integritit³.

Komisioni për Integritin Evropian (KIE)⁴ – është organ i përhershëm i Kuvendit, që ka në fushën e përgjegjësisë së tij çështjet e integritit evropian, përafrimin e legjislacionit shqiptar me legjislacionin e BE-së, monitorimin e zbatimit të angazhimeve që rrjedhin nga MSA, si dhe të asistencës financiare të BE-së. Komisioni ushtron tri funksione kryesore: ligjvënës, kontrollues dhe zgjedhor.

Këshilli i Ministrave (KM)- paraqet çdo vit në Kuvendin e Shqipërisë një raport të detajuar mbi ecurinë e zbatimit të detyrimeve në kuadër të Planit Kombëtar për Integritin Evropian (PKIE), procesin e negociatave të anëtarësimit, menaxhimin e asistencës së Bashkimit Evropian, dhe një raport të veçantë mbi Raportin vjetor të KE për Shqipërinë.

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ)⁵ – bashkërendon dhe monitoron zbatimin e PKIE-së 2021–2023 me grupet ndërinstitucionale të punës (GNPIE) për çdo kapitull dhe raporton çdo tre muaj pranë Këshillit të Ministrave dhe kryenegociatorit për negociatat e anëtarësimit në BE dhe për ecurinë e zbatimit të PKIE-së 2021–2023.

Ministritë dhe institucionet e tjera koordinuese të GNPIE-së - raportojnë çdo muaj pranë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe pranë Kryenegociatorit për negociatat e anëtarësimit në Bashkimin Evropian për ecurinë e zbatimit të PKIE-së 2021–2023.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE), në bashkëpunim me MEPJ, monitorojnë përfshirjen në programin buxhetor afatmesëm, të nevojave financiare për zbatimin e përparësive afatshkurtra dhe afatmesme të parashikuara në PKIE-në 2021–2023.

Disa struktura të tjerë të krijuara ndër vite për të mbështetur negociatat e anëtarësimit janë:

- Kryenegociatori dhe grupi negociator
- Platforma e Partneritetit për Integritin Evropian
- Komiteti Ndërmintor për Integritin Evropian (KNIE);

¹ Përafrimi i legjislacionit, <https://www.parlament.al/DokumentaIntegrimit?integrimId=6>

² <https://www.parlament.al/Files/Integrimit/perberja2019.pdf>

³ Raporti vjetor KËSHILLIT KOMBËTAR TË INTEGRIMIT EUROPIAN 2020

<https://www.parlament.al/Files/Integrimit/Raporti%20i%20KKIE%20p%C3%ABr%20vitet%202020.pdf>

⁴ Komisioni për Integritin Evropian, <https://www.parlament.al/DokumentaIntegrimit?integrimId=5>

⁵ <http://integrimi-ne-be.punetejashtme.gov.al/anetaresimi-ne-be/plani-kombetar-i-integritit-pkie/>



- Komiteti për Koordinimin Ndërinstitucional për Integrimin Europian (KKNIE);
- Bordi i Integritit Europian
- Grupet Ndërinstitucionale të Punës (GNP);

Lista e Ministrive dhe Institucioneve përgjegjëse për Kapitullin 32

1. Ministria e Financave dhe Ekonomisë (institucioni lider)
2. Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH)
3. Banka e Shqipërisë (BSH)
4. Ministria e Brendshme (MB)
5. Ministria e Brendshme /Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (DPPSH)
6. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS)
7. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ)
8. Ministria e Drejtësisë (MD)
9. Agjencia e Auditimit të Projekteve të Asistencës së Akredituar nga BE (AAPAA)
10. Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR)
11. Instituti i Statistikave (INSTAT)